REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:015013

Datë: 21.02.2020

Numri i dokumentit: 00846910

P.nr.32/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Senaver Dorambari, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit A.M, nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 te KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2587-8/2017 të datës 14.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pranin e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me datë 18.09.2019 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.M, nga i ati A. dhe nëna M. e lindur K., i lindur me dtë ... në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga "...", Lam.... nr...., ka të kryer shkollën e mesme, student, i martuar, baba i ... fëmiut, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 17.09.2017 rreth orës 14,30 në Prizren, në rrugën "...", saktësisht përballë furrës së bukës "...", i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 53 dhe 151 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin me një shpejtësi të papërshtatshme për atë pjesë të rrugës, ashtu që deri sa i dëmtuari A.G ishte duke e trupuar rrugën nga furra e bukës "...", për në drejtim të vend parkingut të taksistëve, i pandehuri e godet me pjesën anësore të anës së majtë të veturës, në këmbën e djathtë, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të rënda trupore, lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjeko ligjorë dr. F.B,

Këso dore kanë kryer veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 42 par.1 pika 1.1, 43 par.1 pika 1.2, 45, 73, 74, 75, 76 dhe 378 par 8 lidhur me par 6 dhe par 1 të KP-ës, te akuzuarit i shqipton

komform nenit 47 të KP

Gjykata aprovon propozimin e të akuzuarit, ashtu që dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve burg të akuzuarit i zëvendësohet me

2019:072716

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 1.000 (njëmijë) Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në tre këste të barabarta dhe ate kështin e parë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të aktgjykimit, ndërsa kështet vijuese në afat prej 30 ditësh pas pagesës së kështit paraprakë, nëse dënimi i shqiptuar me gjobë i cekur si zëvendësim i dënimit me burg nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej tre muajsh.

I dëmtuari: A.G, nga Prizreni, rruga "...", nr.... për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe ate në emër të tre ekspertizave mjeko ligjor shumën prej 20,00 euro, dhe në emër të ekspertizës mbi aksidentin e komunikacionit shumën prej 40,88 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumen prej 20,00 Euro, dhe në emër të mbrojtjes së viktimave shumën prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 2587-8/17 të datës 14.01.2019, kundër të akuzuarit A.M, nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 te KP-ës,

Prokurori i shtetit Elfete Purova, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.2587-8/17 të dt.14.01.2019, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari A.M, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, shpreh pendimin tim të thellë për veprën e kryer, por propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mia familjare, që janë person familjar, baba I një fëmiu, moshën time në momentin e kryerjes së veprës, kjo është hera e pare që kam ardhur konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe I propozoj gjykatës që të merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 17.09.2017 rreth orës 14,30 në Prizren, në rrugën "...", saktësisht përballë furrës së bukës "...", i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 53 dhe 151 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin me një shpejtësi të papërshtatshme për atë pjesë të rrugës, ashtu që deri sa i dëmtuari A.G ishte duke e trupuar rrugën nga furra e bukës "...", për në drejtim të vend parkingut të taksistëve, i pandehuri e godet me pjesën anësore të anës së majtë të veturës, në

2019:072716

këmbën e djathtë, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të rënda trupore, lëndime këto të konstatuara nga eksperti mjeko ligjorë dr. F.B,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat e propozuara. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se egziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë e për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 te KP-ës, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjsinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, dhe ate duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata e si rrethanë lehtësuese janë marrë sjellja korrekte e të akuzuarit para gjykatës pas kryerjes së veprës penale, mosha e të akuzuarit, në kohën kur ka shkaktuar veprën penale ka qenë relativisht i ri, si dhe gjendja e tij ekonomike, gjerë më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, komform nenit 74 të KP gjykata mori parasysh rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, është person familjar, baba e një fëmiut, bashkëpunimi i përgjithshëm i të akuzuarit me gjykatën, sjelljen e të akuzuarit pas veprës penale të kryer, pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar, sjellja e të njëjtit pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 (një mijë euro) si dënim zëvendësues i dënimit me burg paraprakisht të shqiptuar në kohëzgjatje prej tre muajve, komform nenit 47 të KP, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.32/2019 me datë 18.09.2019

Procesmbajtësja **Gjyqtari**
Senaver Dorambari **Luan Berisha**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

2019:072716